

Tirane me 29.04.2024

Nr. 1 Prot

KONTRATË

Nr.1

Shitblerje Kuotash të Shoqërisë "LOV TAXI " Sh.p.k., NUIS M31730027F.

Sot më datë 29.04.2024 (dymije e njetekater), ne te nenshkruarit Arben Hamza, dhe z. **Edvin Bica** ortak të shoqërisë "LOV TAXI " Sh.p.k., NUIS M31730027F, ne perputhje me dispozitat e ligjit nr 9901 date 14.4.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", i ndryshuar, rame dakort per hartimin dhe nenshkrimin e kesaj kontrate Shitblerje Kuotash si me poshte vijon:

Z. Arben Hamza, shtetas Shqipëtar, lindur në dt. 26/08/1983, vendlindja Fushë Arrëz (Puke), madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës e letërnjoftimit numër personal (NID) I30826017C, zoterues i 1 kuote te kapitalit të shoqërisë 20% te pjeseve me vlere 20 000 (njetetë mije) lek , I cili ne kontrate eshte me statusin **SHITESI**.

Z. Edvin Bica, shtetas Shqipëtar lindur në dt.19/08/1986, vendlindja Tiranë dhe banues në Tiranë, Shqipëri, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, numër personal (NID) I60819059K, zoterues i 1 kuote te kapitalit të shoqërisë të shoqërisë 20% me vlere 20 000(Njete mije) lek, I cili ne kontrate eshte me statusin **BLERES**.

Hartojmë këtë kontratë shitblerje kuotash me nenet e mëposhtme;

Neni 1

Objekti

Objekt i kësaj kontrate eshte shitblerja e kuotes te zotëruara nga shitësi tek bleresi, 1 kuot e cila përbën 20(njzet) % të kapitalit të shoqërisë "LOV TAXI " Sh.p.k., NUIS M31730027F, me nje vlere 20 000 (Njzet mije) lek.

Neni 2

Çmimi

Çmimi total i vlerës së kontratës është i barabartë me 20000 (Njzet mije) lek.

Neni 3

Mënyra e pagesës

Pala Blerese eshte njohese dhe mbartese e detyrimit ndaj Shitesit per vleren totale te kuotave me vlere 20 000 (Njezet mije) leke. Pala shitesese ka pretendime per shlyerjen totale nga pala Blerese per nje periudhe kohore 10 ditesh .

Neni 4

Të drejtat dhe detyrimet e palëve

Nga nënshkrimi i kësaj kontrate Shitësi humbet të drejtën e pronësisë mbi kuotat në zotërim, pronësi të cilën e fiton Blerësi i cili shndërrohet ne ortak me 1 kuotë me vlere totale 20000 (Njezet mije)lekë.

Pas nënshkrimit të kësaj kontrate ,pala blerëse është pronare e 1 kuote 40 % të pjeseve te kapitalit të kësaj shoqërie.

Të gjitha të drejtat dhe detyrimet që burojnë në bazë të legjislacionit në fuqi nga titulli i pronësisë mbi kuotat objekt shitblerjeje, që nga nënshkrimi i kësaj kontrate i kalojnë Blerësit.

Shitësi dhe blerësi bien dakort që pas nënshkrimit të kësaj kontrate të gjitha të drejtat dhe detyrimet tregtare, tatimore, dhe të tjera të ngjashme, të cilat kanë lindur mbi shoqërinë Lov Taxi dhe ato që do të lindin më vonë, të bien mbi blerësin, në kushtet kur ky i fundit do të jetë ortaku i 40% i shoqërisë.

Neni 5

Hyrja në fuqi

Kjo kontratë hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët pjesëmarrëse.

Neni 6

Të ndryshme

Palët zotohen se do të zgjidhin me mirëkuptim çdo mosmarrëveshje lidhur me këtë kontrate në të kundërt kompetente do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Kjo kontratë iu lexua palëve me zë të lartë. Ato pasi e kuptuan përmbajtjen e saj, e nënshkruan me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë.

Kjo kontratë hartohet në 3 kopje origjinale me fuqi të njëjtë juridike. Një kopje e kesaj kontrate do te depozitohet ne Qendren Kombetare te Regjistrimit per te bere te


mundur regjistrimin e kalimit te kuotave, dhe kopjet e tjera do te mbahen perkatesisht nga nje e tille prej blerësit dhe shitësit.

Sa me siper nenshkruajme kete kontrate me mirekuptim te plote dhe me vullnet te lire.

Shitësi

Arben Hamza

Arben Hamza



Blerësi

Edvin Bica

Edvin Bica

